



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe neni 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-392, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2023, merr këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE
“PRANVERA SHQIPTARE ‘81”

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore “Pranvera shqiptare ‘81”.
- II. Lokacioni nga pika I e këtij vendimi, caktohet në oborrin e Mensës së Studentëve, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban “Prishtina 2012-2022”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01, nr. 035-181427, dt. 24.9.2013, kurse shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale, nr. 7424-2, ZK, Prishtinë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën II të këtij vendimi.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Kadastrit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-353/02-204114/23, më 10.10.2023

KRYESUES I KUVENDIT

Pëllumb Bajçmovci



ARSYETIM

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore “Pranvera Shqiptare ‘81”

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën me 14 nr. 070/01-171513/20 të dt. 22.9.2020 nga këshilli organizativ për shënimin e 40 -vjetorit të “Pranverës Shqiptare ‘81”, drejtuar Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore “Pranvera Shqiptare ‘81”. Bazuar në përmbajtjen e kësaj kërkesë, kushtuar lëvizjes studentore në pranverën e vitit 1981 në Prishtinë, kërkohet të vendoset pllaka përkujtimore në oborrin e Mensës së Studenteve në Prishtinë.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie ka identifikuar lokacionin për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar lëvizjes studentore të vitit 1981, i cili gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban “Prishtina 2012-2022” i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës 01 nr. 035-181427 dt. 24.9.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë për hapësirë për përmbajtje publike dhe hekurudhën e propozuar në afërsi.

Lokacioni i propozuar shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. 7424-2 ZK Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës.

Pllaka përkujtimore “Pranvera Shqiptare ‘81”, është propozuar të vendoset në oborrin e Mensës së Studenteve dhe në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së lartcekur.


Bazuar në gjendjen faktike konstatojmë se hapësira ku do të vendoset pllaka përkujtimore “Pranvera Shqiptare ‘81”, është sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes duhet t’i kushtohet kujdes i veçantë ambientit dhe rregullimit të parterit si dhe ruajtjes së gjelbërimit. Sa i përket madhësisë, formës dhe materialit të kësaj pllake përkujtimore do të përcaktohet në procedurat e mëtejme.

Duke pasur parasysh që dokumentet e planifikimit aktual siç është Plani Zhvillimor Urban nuk i ka të përcaktuara lokacionet për objekte të tilla në nivel të Komunës, ndërsa gjatë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale Komunale, si dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme, këto objekte do të harmonizohen me dokumentet e planifikimit, të cilat janë në proces të hartimit nga Komuna e Prishtinës.

Bashkëngjitur:

Pamje nga Geoportal Kosova

Ekstrakti nga Plani Zhvillimor Urban



Lokacioni i propozuar



Lokacioni i propozuar sipas Planit Zhvillimor Urban